

kanë mbetur deri më **9.09.1998**, kur sërish u ndeshën me forcat serbe. Sadriu, Isufi dhe Azemi kanë rënë gjatë kësaj beteje. Një ditë më vonë, kur situata u qetësua përkohësisht, të mbijetuarit i kanë marrë trupat e Sadriut, Isufit dhe Azemit. Ata u varrosën ditën e nesërme [11.09.1998] në bahçen e familjes Ukaj. Atje prehen edhe sot.

Burimet: deklarata A.U, FDH-29575; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Halil (Sadik) Berisha

(12.12.1941, shqiptar nga Irzniqi/Rzniç, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Halili jetonte me familjen e tij në mëhallën që quhej *Lagja e Spitalit/Bolničko nase-lje*, në Irzniqi/Rzniç. Në datën **10.09.1998**, pjesëtarë të forcave serbe erdhën te shtëpia e Halilit dhe i urdhëruan që të shkonte me ta. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e shihnin atë të gjallë. Pas tri, katër ditësh një grua nga familja Mushkolaj e ka gjetur trupin e Halilit në oborrin e saj [Irzniqi/Rzniç]. Po atë ditë, familjarët i kanë ftuar përfaqësuesit e KNKK-në, të cilët e kanë bartur trupin e Halilit në spitalin e Gjakovës/Dakovica. Pas obduksionit të kryer më 18.09.1998, familja e ka marr trupin e Halilit dhe e ka varrosur po atë ditë në varrezat e Irzniqit/Rzniç.

Burimet: deklarata G.B, FDH-29576; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SMIP, *Teroristički...*, III,913; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

Florije (Selmon Rexhaj) Kamaj

(10.09.1964, shqiptare nga Strellci i Ulët/Donji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, pesë fëmijë)

Florija ka jetuar në fshatin **Strellc i Ulët/Donji Streoc** me bashkëshortin Elezin, katër vajza dhe një djalë. Në muajin maj të vitit 1998, e tërë familja ka kaluar për të jetuar në një kasolle në një bjeshkë mbi fshatin. Edhe bashkëfshatarë të tjerë ishin zhvendosur nëpër kasollet e tyre. Nga mesi i muajit shtator, dy vajzat e Florijes u kthyen në fshat, ndërsa në kasolle kanë mbetur Florija, Elezi dhe fëmijët e tjerë.

Në mëngjesin e datës **17.09.1998**, policët serbë [identiteti i njërit nga ta është i njohur për FDH] e kanë vrarë Florijen. Erdhën në bjeshkë dhe u urdhëruan që të gjithëve që të dalin nga kasollet. Më pas, e kanë ndarë Florijen dhe kanë shtënë drejtpërsëdrejti në kokën e saj, duke e lënë të vdekur në vend. Elezit ia lidhën duart, ndërsa të tjerëve u urdhëruan që të largoheshin dhe të shkonin në fshat, duke shtënë në drejtim të tyre. Dy ditë më vonë [19.09.1998] dhe me lejen e policisë, Elezi dhe disa të afërm dhe komshinj e kanë sjellë trupin e Florijes nga bjeshka. Po atë ditë, Florijen e kanë varrosur në Strellcin e Ulët/Donji Streoc.

Burimet: deklarata G.K, FDH-17047; deklarata E.K, FDH-3531.

Naser (Ramë) Bajramaj

(27.03.1984, shqiptar nga Strellci i Ulët/Donji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani, nxënës)

Nga ora 10:00 të mëngjesit, më **19.09.1998**, Naseri kishte shkuar me kushëririn Fitimin në bjeshkë për të marr disa gjëra në kasolle [bjeshka mbi **Strellcin e Ulët/Donji Streoc**]. Shkuan me kuajt. Pasdite, familja kishte dëgjuar se forcat serbe kanë shkuar drejt bjeshkës. Më vonë, i kanë vërejtur shtëllungat e tymit që vinin nga ai drejtim. Në mbrëmje, diku nga mesnata, i afërmi i familjes Bajramaj, Smajli, i ka lajmëruar babait të Naserit se djalin ia kishin vrarë forcat serbe. Dy ditë më vonë, më 21.09.1998, familja e ka marr lejen e policisë serbe që ta merrte trupin e Naserit. E sollën me kuajt në fshat. Ishte i qëlluar me një plumb mbi belin. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e fshatit Strellci i Ulët/Donji Streoc.

Burimet: deklarata B.R, FDH-17049; deklarata A.B, FDH-12258.

Canë (Mehmet) Çelaj

(9.10.1967, shqiptar nga Strellci i Ulët/Donji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Canë Çelaj jetonte dhe punonte në Malin e Zi tërë kohën përpara luftës në ish Jugosllavi. Më pas, ai me babanë Mehmetin u kthyen në Kosovë, në fshatin e lindjes në Strellcin e Ulët/Donji Streoc. Në fillim të